URDHËR
Nr. 62, datë 17.2.2012

PËR LEJIMIN E FILLIMIT TË VEPRIMTARISË AKADEMIKE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT, AKADEMISË SË STUDIMEVE TË APLIKUARA, DURRËS, NË PËRPUTHJE ME LICENCËN E DHËNË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 693, datë 12.10.2011 "Për licencimin e Akademisë së Studimeve të Aplikuara, Durrës",

URDHËROJ:

1. Lejimin e fillimit të veprimtarisë akademike të Akademisë së Studimeve të Aplikuara, Durrës, për programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në:

a) Menaxhim biznesi;
b) Financë;
c) Mësuesi për arsimin fillor;
d) Mësuesi për arsimin parashkollor;
e) Drejtësi;
f) Infermieri.

2. Programet e studimeve "Bachelor" të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri, realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike. Në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Bachelor" në fushën e arsimit të kryer.

3. Veprimtaria akademike, për programet e studimeve të sipërpërmendura në këtë urdhër, të fillojë në vitin akademik 2011-2012.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe Akademia e Studimeve të Aplikuara, Durrës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj